

STATUTI DHE AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"GEA SYSTEM" SH.P.K.

Mbështetur në ligjin nr. 9901 datë 20.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare", në ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për QKR", sot më datë 16 prill 2020 me vullnetin e lirë dhe të plotë vendosëm të krijojmë dhe miratojmë statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "GEA SYSTEM" Sh.p.k. me këtë përmbajtje

Neni 1 – Forma dhe emërtimi.


Shoqëria "GEA SYSTEM" Sh.p.k. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, subjekt juridik shqiptar, veprimtaria e së cilës do të rregullohet me anë të këtij Statuti dhe nga legjislacioni shqiptar në fuqi. Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKR në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Ky statut është përpiluar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ka karakter të detyrueshëm për nënshkruarit e tij. Çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Themeluesit.

Themeluesit e shoqërisë "GEA SYSTEM" Sh.p.k. janë:

- **Z. Adrian Thano**, shtetas shqiptar, lindur më 13.03.1975 në Fier, Shqipëri dhe banues në Tiranë, i identifikuar me letërnjoftim nr. 035922763 dhe me numër personal H50313049C, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- **Z. Giuseppe Ayroldi**, shtetas italian, lindur më 03.06.1972 në Molfetta, Bari, Itali, dhe banues në Cellatica, Brescia, Itali, i identifikuar me kartën e identitetit nr. AR 4449112 dhe me kodin fiskal nr. YRLGPP72H03F284J, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;



- Z. Elton Xhanari, shtetas shqiptar, lindur më 22.10.1986 në Tiranë, Shqipëri dhe banues në Tiranë, i identifikuar me me letërnjoftim nr. 031560491 dhe me numër personal 161022042J madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 3 – Selin.



Shoqëria "GEA SYSTEM" Sh.p.k. e ka selinë në: 1019 Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga Sami Frashëri, ND. 30, Hyrja 2, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë vetëm me vendim të Asamblesë së përgjithshme të ortakëve.

Neni 4 – Objekti.

Shoqëria "GEA SYSTEM" Sh.p.k. do ketë si objekt të veprimtarisë: a) Dhënie e shërbimeve të konsulencës në fushën e investimeve përfshirë themelimin, regjistrimin, përfaqësimin dhe administrimin e shoqërive të reja; b) Konsulencë për investimet e huaja direkte nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate të vecantë ndërmjetësimi; c) Import-Eksport, tregtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve, me shumicë dhe pakicë si tregtimi i artikujve të ndryshëm industrialë, materiale për mbrojtjen dhe monitorimin e shëndetit si termokamera dhe termometra, materiale ushqimorë, bujqësorë e bioktoralë, fruta perime, pije alkolike të ndryshme, konfeksione të ndryshme, tregtim prodhimesh kozmetike dhe estetike, transport mallrash të të gjitha llojeve brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, tregtim produktesh higjieno-sanitare, pajisje zyrash etj.; d) Aktivitet në fushën e mediave, ndërmjetësim, publikim dhe import/export paisjesh të lidhura me fushën e medias dhe produksionit. d) Çfarëdolloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.

Shoqëria "GEA SYSTEM" Sh.p.k. ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj me vendim të Asemblesë së përgjithshme të ortakëve.



Neni 4 – Kohëzgjatja.

Shoqëria "GEA SYSTEM" Sh.p.k. kryen veprimtarinë e saj tregtare për një periudhë kohore të pacaktuar derisa të vendoset ndryshe nga Asambleja e përgjithshme e ortakëve.

Neni 5 – Kapitali themeltar.

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë "GEA SYSTEM" Sh.p.k. është 1.000 (një mijë) lekë. Pjesëmarrja e themelueseve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- Ortaku themelues Z. Adrian Thano: zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 340 (treqind e dyzet) lekë që përbën 34% të kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Ortaku themelues Z. Giuseppe Ayroldi: zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 330 (treqind e tridhjetë) lekë që përbën 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Ortaku themelues Z. Elton Xhanari: zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 330 (treqind e tridhjetë) lekë që përbën 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.


Kapitali themeltar është i nënshkruar plotësisht nga ortakët themelues në masën 100%. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme / të paluajtshme apo të drejta). Ortakët përgjigjen për humbjen e shoqërisë përkundrajt të tretëve deri në vlerën e kontributit të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6 – Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit.

Kapitali i shoqërisë "GEA SYSTEM" Sh.p.k. mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga Gjykata kompetente të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.







Në asnjë rast shumica e ortakëve nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e përgjithshme e ortakëve e cila merr vendimin në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e Statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7 – Transferimi i kapitalit.

Kuotat e kapitalit të shoqërisë "GEA SYSTEM" Sh.p.k. e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: a) kontributit në kapitalin e shoqërisë; b) shitblerjes; c) trashëgimisë; d) dhurimit; e) çdo mënyrë tjetër e parashikuar me ligj.

Në rast transferimi të kuotës së kapitalit themeltar tek një subjekt i tretë, ortaku është i detyruar të lajmërojë ortakët e tjerë të paktën 30 (tridhjetë) ditë para duke i venë në djeni mbi kushtet e transferimit. Ortakët e tjerë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i sipërpërmëndur mund të ushtrojnë të drejtën e parablerjes me të njëjtat kushte.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa kohë nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8 – Organi vendimarrës. Asambleja e përgjithshme të ortakëve.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme: a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; b) emërimin, shkarkimin dhe përcaktimin e shpërblimeve të administratorëve; c) emërimin e shkarkimin, dhe përcaktimin e shpërblimeve të likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; d) mbikëqyrjen e zbatimit të

politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit; g) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre; h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimentet e tjera ndaj administratorëve; i) riorganizimin e shkrijen e shoqërisë; l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë; m) çështje të tjera të miratura nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblesë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblesë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së përgjithshme, e cila mund të përfshijë edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9 – Organi vendimarrës. Asambleja e përgjithshme e ortakëve.

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Avila
Elton

Elton

5
Elton

Neni 10 – Kuorumi.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.


Në rastin kur Asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, votojnë personalisht, me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse Asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11 – Marrja e vendimeve.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve vendos me tre të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve; c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; d) përcaktimin e shpërblimeve; e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;



Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12 – Përjashtimi nga e drejta e votës.

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
a) vlerësimin e veprimtarisë së tij; b) shuntjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; d) dhënieve ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.


Neni 13 – Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.


Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme së ortakëve:


- **Z. Adrian Thano**, shtetas shqiptar, lindur më 13.03.1975 në Fier, Shqipëri dhe banues në Tiranë, i identifikuar me letërnjoftim nr. 035922763 dhe me numër personal H50313049C, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar



specimenë e nënshkrimit






17


Neni 14 – Kompetencat e administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të: a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme; b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare; c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim; e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë; f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit; g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e aktiviteve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblesën e Përgjithshme, në rastet kur: a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim; c) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 (pesë) për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara; d) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 (pesë) për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.



Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Gjatë dy viteve të para të shoqërisë, administratori nuk do ketë të drejtë shpërblimi për aktivitetin e tij.




Neni 15 - Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajë të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet: a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis; b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita; c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim; d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë; e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.



Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.


Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme: a) u kilhen ortakëve kontributet; b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë; c) u shpërndan aktivet shoqërisë; d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet; e) jep kredi.


Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 16 - Viti Financiar dhe dispozita të përkohshme mbi ndarjen e fitimeve të shoqërisë.

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.



10


Gjatë dy viteve të para të shoqërisë, ortakët themelues vendosin të mos ndajnë midis tyre fitimet e aktivitetit tregtar në optikën e përforsimit të mëtejshëm të shoqërisë dhe të investimeve për rritjen e saj.

Duke u nisur nga bilanci vjetor i tretë, fitimet e shoqërisë tregtare do shpërndahen rregullisht në proporcion me kuotat e secilit prej ortakëve.

Neni 17 - Prishja dhe likuidimi i shoqërisë.

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë: a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve; c) me hapjen e procedurave të falimentimit; c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"; d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtimin shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".


Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 18 - Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."




Neni 20 - Daza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.


Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", e Kodit Civil dhe të çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


Neni 21 – Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.


Z. Adrian Thano

ORTAKËT
E SHOQËRISË ME PËRQJEGJËSI TË KUFIZUAR
GEA SYSTEM


Z. Giuseppe Ayroldi


Z. Elton Xhanari